LIGJ
Nr.7572, datë 10.6.1992

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PUSHTETIT LOKAL

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në çdo komunë, bashki dhe rreth organizohet dhe funksionon pushteti lokal. Organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal bazohet në parimet e vetëqeverisjes, autonomisë lokale, të ligjshmërisë dhe të zgjedhshmërisë.

Neni 2

Ndarja administrative-tokësore e Republikës së Shqipërisë bëhet nga Këshilli i Ministrave.

Rrethet e reja mund të krijohen nga bashkimi i komunave dhe bashkive, të lidhura midis tyre nga faktorë historikë, socialë dhe ekonomikë, me popullsi jo më pak se 25 mijë banorë dhe me pasuri të mjaftueshme për vetëqeverisje.

Neni 3

Organet e pushtetit lokal veprojnë si organe të pavarura dhe drejtojnë punët publike në njësitë territoriale përkatëse.

Marrëdhëniet ndërmjet organeve të rrethit me ato të njësive të tjera administrative-tokësore bazohen në parimin e autonomisë dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Ndërmjet tyre nuk ekzistojnë marrëdhënie vartësie.

Neni 4

Problemet e një rëndësie të veçantë të njësisë administrativetokësore mund të zgjidhen nëpërmjet referendumit popullor, në të cilin marrin pjesë banorët e njësisë që gëzojnë të drejtën e votës.

Rregullat dhe rastet e referendumit caktohen me ligj.

Neni 5

Organet e pushtetit lokal mund të shpërndahen me vendim të organit kompetent, në këto raste:

1. Kur këshilli kryen veprime që vijnë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese ose përbëjnë shkelje të rënda të ligjit.

2. Kur këshilli i rrethit nuk i pergjigjet kërkesës së Këshillit të Ministrave për shkarkimin e organit ekzekutiv ose të kryetarit apo të anëtarëve të veçantë të tij, që kanë kryer veprime si ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Kur këshilli nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet e tij për shkak se nuk mund të formojë shumicën në marrjen e vendimeve.

4. Kur e kërkojnë interesat e sigurimit kombëtar.

5. Kur bëhen ndryshime në ndarjen administrative-tokësore.

Në vendimin e shpërndarjes caktohet komisioni që do të përgatisë zgjedhjet e reja, të cilat bëhen brenda 45 ditëve nga dita e shpërndarjes. Ky komision ushtron përkohësisht funksionet e organit të shpërndarë.

KREU II
KËSHILLAT E KOMUNAVE DHE TË BASHKIVE, PËRBERJA DHE KRIJIMI I TYRE

Neni 6

Këshillat e komunave dhe të bashkive përbëhen nga këshilltarë të zgjedhur sipas rregullave të caktuara në ligjin për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal.

Neni 7

Numri i anëtarëve të çdo këshilli caktohet sipas ligjit të zgjedhjeve, në raport me numrin e popullsisë.

Neni 8

Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:

a) funksionet e anëtarit të këshillit të rrethit, si dhe me detyrën e funksionarit në ministri e në institucione qendrore;

b) funksionin e kryetarit të komunës dhe të bashkisë.

Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në dy këshilla të komunave ose të bashkive.

Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat që janë me njëri-tjetrin; bashkëshort, prindër e fëmijë ose vëllezër e motra, si dhe vjerri, vjehrra, dhëndri e nusja.

Neni 9

Këshillat e komunave dhe të bashkive krijohen brenda 20 ditëve nga dita e zgjedhjeve. Thirrja e këshillit në mbledhjen e parë bëhet nga kryetari i komunës ose i bashkisë.

Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të merr pjesë të paktën 2/3 e numrit të këshilltarëve. Kur nuk arrihet shumica e kërkuar, mbledhja zhvillohet 3 ditë më vonë.

Mbledhja e parë e këshillit drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë, i ndihmuar nga dy këshilltarë të tjerë.

Neni 10

Këshillat zgjedhin nga radhët e anëtarëve të tyre një komision për verifikimin e mandatit të këshilltarëve. Komisioni përbëhet nga 3 deri në 5 këshilltarë dhe qëndron i zgjedhur gjatë gjithë kohës në të cilën vazhdon mandati i këshillit.

Komisioni i mandateve verifikon kushtet ligjore për zgjedhjen e çdo këshilltari dhe i propozon këshillit vërtetimin ose anullimin e mandatit të këshilltarëve.

Komisioni i mandateve mund të propozojë anullimin e mandatittë një këshilltari vetëm në rastet kur:

a) Konstaton ekzistencën e e papajtueshmërisë së funksioneve ose shkeljen e kushteve ligjore të zgjedhshmërisë;

b) Konstaton se zgjedhja e këshilltarit është bërë me mashtrim, falsifikim ose mënyra të tjera të kundërligjshme.

Vërtetimi ose anullimi i mandateve bëhet me shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve .

Këshilltari nuk mund të votojë për mandatin e tij.

Ankimi kundër vendimit të këshillit për anullimin e mandatitbëhet në gjykatë nga personi i

interesuar. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

Këshilli kushtetuohet pas vërtetimit të madateve të jo me pak se 2/3 e anëtarëve të tij.

Neni 11

Pas vërtetimit të madateve këshilltarët betohen përpara këshillit me këtë formulë:

"Betohem në emër të zgjedhësve që përfaqësoj, të mbroj Kushtetutën e ligjet dhe në të gjithë veprimtarinë time të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të komunës ose të bashkisë dhe të punoj për rritjen e mirëqenies së tyre".

Këshilltari që refuzon të bëjë betimin, konsiderohet se tërhiqet nga funksioni i tij.

Neni 12

Mandati i këshilltarit pushon para afatit për të cilin është zgjedhur në rastet e dorëheqjes, të papajtueshmërisë së funksioneve kur shpërndahet këshilli, kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, kur shkarkohet nga organi kompetent, kur ndryshon vendbanimin dhe shkon në një njësi tjetër administrative-tokësore.

Neni 13

Këshilli i komunes ose i bashkisë zgjedh nga rradhët e tij komisione për fusha të veçanta, veprimtaria e të cilave caktohet me rregulloren e këshillit. Anëtarët e kryesisë së këshillave nuk mund të marrin pjesë në këto komisione.

KOMPETENCAT E KËSHILLAVE TË KOMUNAVE DHE TË BASHKIVE

Neni 14

Këshilli i komunës ose i bashkisë ka iniciativë dhe vendos për problemet që hyjnë në juridiksionin e tij, me përjashtim të atyre që me ligj janë lënë në kompetencën e organeve të tjera.

Këshilli ka këto kompetenca kryesore:

1. Zgjedh zëvendëskryetarin e komunës ose të bashkisë.
2. Miraton statutin dhe rregulloren e këshillit.
3. Miraton studimet prognozë dhe programet e zhvillimit ekonomiko-shoqëror.
4. Me propozimin e kryetarit të komunës ose të bashkisë cakton strukturën dhe organikën e personelit.
5. Miraton buxhetin dhe ndjek administrimin dhe zbatimin e tij.
6. Vendos taksat dhe detyrimet e tjera të caktuara me ligj.
7. Administron pasuritë e komunës ose të bashkisë.
8. Siguron ruajtjen e rendit publik dhe respektimin e të drejtave e lirive themelore të shtetasve.
9. Krijon institucione dhe njësi ekonomike sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
10. Emëron dhe shkarkon anëtarët e këshillave drejtues tëndërmarrjeve me kapital shtetëror me karakter lokal dhe anëtarët e këshillave të përfaqësuesve të shtetit në shoqëritë tregtare me karakter lokal në të cilat shteti merr pjesë me kapital.
11. Siguron një funksionim të mirë të shërbimeve komunale të transportit lokal, rrjetit rrugor dhe shërbimit postar.
12. Siguron zbatimin e programeve të zhvillimit urbanistik.
13. Siguron kushtet e nevojshme për funksionimin e mirë tëinstitucioneve lokale të arsimit, të shëndetësisë, të kulturës dhe të rinisë, që janë nën drejtimin e tij.
14. Merr masa për punësimin dhe strehimin e shtetasve, sidhe siguron kushtet e favorshme për veprimtari shkencore, kulturore, artistike, sportive dhe shlodhjeje.
15. Merr masa për të mbrojtur e ripërtërirë mjedisin, ndihmon për ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve me vlera historike dhe kulturore, si dhe të parqeve e pasurive natyrore.
16. Siguron tregëtinë e lirë dhe konkurrencën, duke stimuluar iniciativën e lirë private sipas

ligjit.

17. Krijon institucione bamirësie me karakter lokal.

18. Organizon panaire dhe tregje.

19. U jep titullin e qytetarit të nderit të komunës ose të bashkisë shtetasve shqiptarë ose të huaj për merita të shquara.

20. Vendos, sipas ligjit, për krijimin e shoqërive të përbashkëta me komunat e bashkitë e tjera, si dhe me firmat e brendshme e të jashtme për kryerjen e veprimtarive me interes reciprok.

21. Vendos për përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimitme organet e ngjashme jashtë shtetit.

Për realizimin e kompetencave të tij këshilli nxjerr urdhëresa e vendime.

Këshilli ushtron gjithashtu kompetenca të tjera të caktuara me ligj ose me statutin e komunës apo të bashkisë.

FUNKSIONIMI I KËSHILLAVE TË KOMUNAVE DHE TË BASHKIVE

Neni 15

Këshilli i komunës ose i bashkisë qëndron i zgjedhur për 4 vjet.

Mandati i këshilltarit është i vlefshëm që nga koha e betimit deri në kushtetuimin e këshillit të ri.

Këshilli zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin e tij, meshumicë të thjeshtë votash.

Neni 16

Këshilli i komunës ose i bashkisë thirret në mbledhje të zakonshme mujore nga kryetari i komunës ose i bashkisë.

Këshilli mund të thirret në mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesën e kryetarit të komunës ose të bashkisë ose të së paku 1/3 së anëtarëve të këshillit.

Thirrja e këshillit bëhet së paku 5 ditë përpara mbledhjes së zakonshme.

Thirrja bëhet me shkrim dhe shënohet në aktet e mbledhjes. Në thirrje specifikohet rendi i ditës, data ora dhe vendi i mbledhjes.

Rendi i ditës u njoftohet banorëve të komunës ose të bashkisë me anë të shtypit lokal ose mjeteve të tjera të informimit publik.

Neni 17

Mbledhja e këshillit të komunës ose të bashkisë quhet e vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve të këshillit.

Kur një këshilltar mungondy herë radhazi pa arësye të përligjura, ndaj tij mund të merren masa sipas rregullores së këshillit.

Kur këshilli nuk mund të veprojë për shkak të mungesës sëpapërligjur të anëtarëve pas 3 thirrjeve radhazi, ai quhet i vetëshpërndarë.

Vetëshpërndarja e këshillit i njoftohet Këshillit të Ministrave dhe pasohet nga organizimi i zgjedhjeve të reja.

Neni 18

Mbledhjet e këshillit të komunës ose të bashkisë janë publike me përjashtim të rasteve kur vetë këshilli, me shumicë votash, vendos që ato të bëhen të mbyllura.

Problemet e buxhetit diskutohen kurdoherë në mbledhje publike.

Neni 19

Mbledhjet e këshillit fiksohen në procesverbalin e firmosurnga kryetari, sekretari dhe së paku nga 3 këshilltarë.

Këshilltarët kanë të drejtë të kërkojnë që t'u vihen në dispozicion procesverbalet e mbajtura në mbledhjet e këshillit dhe të bëjnë vërejtje.

Neni 20

Rendi i ditës miratohet nga këshilli, me propozimin e atij që ka kërkuar thirrjen e mbledhjes sipas nenit 16 të këtij ligji. Ndryshimet në rendin e ditës mund të bëhen vetëm për probleme të ngutshme.

Neni 21

Këshilli i komunës ose i bashkisë aktet i nxjerr me shumicën absolute të votave të anëtarëve që janë të pranishëm, me përjashtim të rasteve kur ligji apo rregullorja e këshillit kërkon një shumicë tjetër. Në rast barazimi votash vendimi nuk miratohet.

Aktet që kanë të bëjnë me buxhetin, vendosjen e detyrimeve dhe të taksave lokale, administrimin e pasurisë së komunës ose të bashkisë, me organizimin e zhvillimin urbanistik dhe për shoqëritë e përbashkëta me këshillat e tjera ose firma të brendshme apo të jashtme, merren me jo më pak se 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit.

Këshilli mund të vendosë që akte të caktuara të merren me votim të fshehtë. Aktet që lidhen me persona fizikë merren kurdoherë me votim të fshehtë.

Projektet e akteve mund të propozohen nga këshilltarët ose nga kryetari i komunës apo i bashkisë.

Neni 22

Aktet e këshillit të komunës ose të bashkisë nënshkruhen nga kryetari i këshillit.

Aktet normative bëhen të detyrueshme nga data e shpalljes kurse ato individuale nga data e njoftimit të tyre.

Nei 23

Këshilltari nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin dhe miratimin e aktit të këshillit kur :

a) vetë ai, bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, vjehrri, vjehrra, dhëndri e nusja e tij ka interes pasuror ose interes tjetër me çështjen që diskutohet në këshill;

b) është anëtar i këshillit drejtues të një shoqërie, interesat e së cilës lidhen me çështjen që diskutohet në këshill.

Shkelja e rregullave të mësipërme sjell si pasojë pavlefshmërinë e aktit.

Neni 24

Këshilltarët janë bashkërisht përgjegjës për veprimtarinë ekëshillit në të cilin marrin pjesë dhe për aktet e marra.

Çdo këshilltar përgjigjet për veprimtarinë e tij gjatë periudhës së mandatit.

Neni 25

Gjatë kryerjes së detyrës dhe për shkak të saj këshilltari mbrohet me ligj.

Kur një anëtar i këshillit kryen veprime që vijnë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjet ose dëmton interesat ekomunës apo të bashkisë, ai mund të shkarkohet nga funksioni me vendim të këshillit të rrethit mbi bazën e propozimit të kryetarit të komunës ose të rrethit.

Neni 26

Në mbledhjet e këshillit mund të marrin pjesë, pa të drejtëvote, deputetë, kryetari i këshillit të rrethit ose përfaqësuesite tij, si dhe persona të tjerë të ftuar, prania e të cilëve çmohet e nevojshme.

Neni 27

Organet ekzekutive dhe administrata publike të njësisë administrative përkatëse janë të detyruara që t'u japin të dhëna këshilltarëve, me kërkesën e këtyre të fundit, jo më vonë se 15 ditë.

KREU III
KRYETARI I KOMUNËS OSE I BASHKISË

Neni 28

Çdo komunë ose bashki ka kryetarin të zgjedhur me votim të përgjithshëm për çdo 4 vjet.

Ai ndihmohet nga një ose disa zëvendëskryetarë.

Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga këshilli i Ministrave.

Kryetari dhe zëvendëskryetarët gjatë kohës që janë të z zgjedhur nuk mund të punojnë në ndërmarrjet ose shoqëritë me kapital shtetëror, në institucionet buxhetore ose për llogari të tyre.

Neni 29

Vërtetimi i vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të komunësose të bashkisë bëhet brenda 20 ditëve nga dita e zgjedhjes, prejnjë gjyqtari të caktuar nga kryetari i gjykatës në juridiksionin e së cilës përfshihet komuna ose bashkia.

Deklarimi i pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit bëhet nërastet e parashikuara nga neni 10 i këtij ligji.

Vërtetimi i vlefshmërisë së mandatit shpallet në mbledhjen që kushtetuohet këshilli i komunës ose i bashkisë apo, siç mund të paraqitet rasti, në një mbledhje të jashtëzakonshme.

Në rast të vërtetimit të pavlefshmërisë së mandatit të kryetarit të komunës ose të bashkisë organizohen zgjedhje të reja brenda 45 ditëve nga data e vërtetimit të pavlefshmërisë.

Neni 30

Kryetari bën betimin përpara këshillit të komunës ose të bashkisë.

Kur kryetari refuzon të bëjë betimin konsiderohet se ka dhënë dorëheqjen.

Neni 31

Mandati i kryetarit të komunës ose të bashkisë mbaron në datën kur bën betimin kryetari i ri.

Mandati i kryetarit mund të mbarojë përpara afatit kur jep dorëheqjen, kur dënohet penalisht, në rastet e papajtueshmërisë së funksionit të tij me funksione të tjera të parashikuara nga ky ligj, si dhe në rast shkarkimi.

Neni 32

Kryetari i komunës ose bashkisë mund të shkarkohet me dekrettë Presidentit të Republikës mbi propozimin e motivuar të kryetarit të Këshillit të Ministrave, kur kryen akte në kundërshtim me Kushtetutën ose shkelje të rënda të ligjit apo të rendit publik.

Neni 33

Kryetari i komunës ose i bashkisë merr pjesë në mbledhjet e këshillit, drejton administratën lokale publike dhe është përgjegjës përpara këshillit për funksionimin e saj të mirë.

Kryetari përfaqëson komunën ose bashkinë në organet shtetërore dhe në marrëdhëniet e saj me personat fizikë ose juridikë të vendit dhe të huaj.

Simboli dallues i kryetarit të komunës ose bashkisë është një shirit me ngjyrat e flamurit shtetëror. Kryetari duhet ta mbajë detyrimisht këtë shirit në mbledhjet solemne, pritjet zyrtare, ceremonitë publike dhe në ceremonitë e lidhjes së martesave.

Modeli i këtij shiriti caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 34

Kryetari i komunës ose bashkisë ka këto kompetenca e detyra kryesore:

1. Siguron respektimin e të drejtave dhe lirive themelore tështetasve, të dispozitave kushtetuese, të ligjeve dhe akteve tëtjera të nxjerra në zbatim të tyre.

2. Siguron rendin dhe qetësinë publike me mbështetjen e organeve të ruajtjes së rendit.

3. Siguron zbatimin e vendimeve të këshillit të komunës ose të bashkisë. Kur çmon se një vendim është i kundërligjshëm, ai njofton brenda 7 ditëve Kryesinë e Këshillit të Rrethit.

4. I raporton këshillit çdo 6 muaj ose kurdoherë që kërkohetpër gjendjen ekonomike dhe sociale të komunës ose të bashkisë.

5. Përgatit projektbuxhetin lokal e mbylljen e llogarisë fin-anciare të vitit buxhetor dhe ia parashtron ato për miratim këshillit.

6. Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar komunës ose bashkisë si person juridik.

7. Verifikon me iniciativë ose sipas kërkesës të ardhurat e shpenzimet e buxhetit lokal dhe rezultatin ja njofton këshillit.

8. Së bashku me organet e specializuara merr masa për parandalimin dhe pakësimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, katastrofave, zjarreve, epidemive, rreziqeve nga kafshët. Për këtë qëllim ai mund të mobilizojë edhe popullsinë.

9. Organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e rojave publike.

10. Merr masa për ndalimin ose pezullimin e shfaqeve apo manifestimeve të tjera publike, kur vijnë në kundërshtim me rendin ligjor ose cënojnë moralin shoqëror, rendin publik dhe qetësinë.

11. Kontrollon sigurimin e kushteve higjenike e shëndetësore të lokaleve publike dhe të produkteve ushqimore në qarkullim.

12. Siguron përgatitjen e programit të zhvillimit urbanistik lokal e dokumentacionin e planeve rregulluese.

13. Siguron ruajtjen në kushte të mira të rrugëve publike nëkomunë ose bashki, vendosjen e shenjave rrugore, si dhe trafikun rrugor normal.

14. Kontrollon panairet, tregjet, mirëmbajtjen e vendeve të dëfrimit dhe të parqeve e merr masa të shpejta për funksionimin emirë të tyre.

15. Drejton shërbimet publike lokale.

16. Urdhëron shpalljen e njoftimeve publike.

17. Përgatit strukturën dhe cakton numrin e punonjësve të kom-unës ose bashkisë e pagat e tyre dhe ia paraqet për miratim këshillit të komunës ose bashkisë.

18. Emëron dhe shkarkon personelin e administratës së komunësose bashkisë.

19. Organizon inventarizimin e pasurisë që i përket komunës ose bashkisë dhe kontrollon administrimin e saj.

20. Merr masa për zbatimin e ligjit për shërbimin veterinar efitosanitar.

21. Siguron mbrojtjen e mjedisit në komunë ose bashki.

Kryetari i komunës ose bashkisë ushtron kompetenca të tjera të parashikuara me ligj.

Neni 35

Kryetari i komunës ose bashkisë mund t'ia delegojë disa ngakompetencat e tij zëvëndëskryetarit të komunës ose bashkisë, ose sekretarit të këshillit.

Neni 36

Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij kryetari i komunës ose bashkisë nxjerr vendime dhe urdhra. Këto hyjnë në fuqi, sipas rastit, me shpalljen e tyre ose pasi u njoftohen personave të interesuar.

Neni 37

Kryetari i komunës ose bashkisë, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, mbrohet me ligj.

KREU IV
SEKRETARI I KËSHILLIT TË KOMUNËS OSE BASHKISË

Neni 38

Çdo këshill komune ose bashkie ka sekretarin e tij, i cili është funksionar.

Neni 39

Sekretari i këshillit të komunës ose bashkisë emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli i Ministrave. Emërimi bëhet me konkurs.

Neni 40

Sekretari ka këto kompetenca kryesore:

1. Merr masa për mbledhjen e këshillit.
2. Kujdeset për përgatitjen e materialeve që do t'i nënshtrohen diskutimeve në këshill.
3. U komunikon dhe parashtron autoriteteve e personave të interesuar aktet e nxjerra nga këshilli ose kryetari i komunës apo i bashkisë brenda 10 ditëve.
4. Merr masa që opinioni publik të njoftohet për vendimet dhe rregullat me interes të përgjithshëm.
5. Shpërndan ekstrate ose kopje të akteve të arkivuara të këshillit, me përjashtim të atyre që me ligj nuk lejohet të shpërndahen.
6. Verifikon nënshkrimet dhe konfirmon autenticitetin e kopjeve të akteve me origjinalin, me përjashim të atyre që janë nxjerrë nga organet qendrore.
7. Merr dhe shpërndan korrespondencën.
8. Kujdeset për kryerjen e punëve të sekretarisë.

Sekretari kryen gjithashtu edhe detyra të tjera të caktuara me ligj ose që i caktohen atij nga këshilli apo kryetari i komunës ose bashkisë.

KREU V
KËSHILLI I RRETHIT PËRBERJA DHE KRIJIMI I KËSHILLIT TË RRETHIT

Neni 41

Këshilli i rrethit përbëhet nga këshilltarët e zgjedhur sipas ligjit për zgjedhjet.

Neni 42

Numri i këshilltarëve për çdo rreth caktohet në raport me numrin e popullsisë së saj të regjistruar më 1 janar, sipas kritereve të caktuara në ligjin për zgjedhjet.

Neni 43

Keshilli i rrethit duhet të krijohet brenda 20 ditëve nga dita e zgjedhjes së tij. Mbledhjen e parë të këshillit e thërret Këshilli i Ministrave.

Neni 44

Për krijimin e këshillit veprojnë rregullat e parashikuara nga nenet 9-13 të këtij ligji.

KOMPETENCAT E KËSHILLIT TË RRETHIT

Neni 45

Këshilli i rrethit ka këto kompetenca kryesore:

1. Zgjedh ndërmjet këshilltarëve kryetarin, zëvendëskryetarin dhe kryesinë e këshillit të rrethit.

2. Koordinon veprimtarinë e këshillave të komunave ose bashkisë.

3. Organizon e kontrollon administratën e këshillit të rrethit dhe miraton rregulloren e saj; cakton strukturën dhe numrin e personelit.

4. Analizon propozimet e bëra nga komunat dhe bashkitë nëlidhje me përpunimin e programeve ekonomike dhe për ripërtëritjene ruajtjen e mjedisit.

5. Miraton programet e prognozat e zhvillimit social ekonomik të rrethit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

6. Miraton buxhetin e rrethit dhe mbylljen e llogarisë financiare të vitit.

7. Vendos drejtimet e rregullimit dhe zhvillimit urbanistik të rrethit.

8. Drejton sektorin publik dhe mbështet veprimtarinë private në rreth, sipas kompetencave të caktuara me ligj.

9. Kontrollon zbatimin e ligjeve dhe të vendimeve të pushtetit lokal nga organet e ruajtjes së rendit.

10. Siguron ndërtimin, mirëmbajtjen dhe modernizimin e rrugëve në shkallë rrethi, si dhe rrugët lidhëse me rrethet fqinjë.

11. Miraton rregulloren e këshillit të rrethit.

12. Vendos taksat dhe tatimet lokale në shkallë rrethi, si dhe ato të veçanta për periudha të caktuara kohe, në bazë të kompetencave të njohura me ligj.

13. Pezullon aktet e paligjshme të komunave e të bashkive dheu kërkon atyre që t'i rishqyrtojnë. Kur organi që ka nxjerrë aktin nuk e anullon atë, atëhere këshilli i rrethit ia dërgon atë gjykatës, vendimi i së cilës është i formës së prerë.

14. Krijon institucione dhe njësi ekonomike për nevoja të rrethit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

15. Krijon institucione socialkulturore dhe shëndetësore përnevojat e rrethit dhe siguron funksionimin e mirë të tyre.

16. Siguron kushtet për organizimin e veprimtarive shkencore, kulturore, artistike, sportive dhe të rinisë.

17. Emërton rrugët, sheshet dhe vendet e tjera publike sipas rregullave të caktuara me ligj.

Neni 46

Këshilli i rrethit ushtron edhe kompetenca të tjera të caktuara me ligj.

FUNKSIONIMI I KËSHILLIT TË RRETHIT

Neni 47

Këshilli i rrethit zgjidhet për një periudhë prej 4 vjetësh.

Këshilltarët ushtrojnë mandatin e tyre që nga dita e betimit, deri në mbledhjen e parë të këshillit të ri.

Neni 48

Këshilli i rrethit thirret në mbledhje të zakonshme një herë në 3 muaj.

Këshilli mund të thirret edhe në mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesën e kryetarit të këshillit, të jo më pak se 1/3 së numrit të anëtarëve të këshillit apo me kërkesën e kryesisë.

Kryetari i këshillit thërret mbledhjen e zakonshme të këshillit të paktën 10 ditë përpara.

Për funksionimin e këshillit të rrethit zbatohen nenet 17-27 të këtij ligji.

Neni 49

Këshilli i rrethit nxjerr urdhëresa e vendime për ushtrimin e kompetencave të tij.

KREU VI
KRYESIA DHE KRYETARI I KËSHILLIT TË RRETHIT

Neni 50

Këshilli i rrethit zgjedh kryesinë e përbërë nga 5-7 këshilltarë, kryetarin dhe zëvendëskryetarin e saj.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit të rrethit zgjidhenndërmjet këshilltarëve të rrethit, me shumicë votash.

Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit të rrethit janë në të njëjtën kohë kryetar dhe zëvendëskryetar të kryesisë.

Neni 51

Kryesia e këshillit të rrethit koordinon punën operative të administratës publike të këshillit, zbaton vendimet e këshillit të thit dhe ushtron kompetencat e tij, gjatë kohës që nuk është i mbledhur me përjashtim të atyre që parashikohen në nenin 45, pikat 1, 5, 6, 7, 11, 12, 14 dhe 15 të këtij ligji.

Për ushtrimin e kompetencave të saj kryesia nxjerr vendime, të cilat bëhen të zbatueshme pasi të shpallen ose t'u njoftohen organeve apo personave që u drejtohen.

Rregullat e parashikuara në nenin 21, paragrafi i tretë, zbatohen edhe për kryesinë e këshillit të rrethit.

Neni 52

Kryetari i këshillit të rrethit ka këto kompetenca kryesore:

1. Kryeson mbledhjet e këshillit të rrethit dhe të kryesisë së tij.
2. Drejton administratën publike të rrethit dhe përgjigjet për funksionimin e mirë të saj.
3. Siguron zbatimin e vendimeve të këshillit të rrethit dhe të kryesisë së tij.
4. Mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve dhe të shoqërive ekonomike prodhuese të rrethit.
5. Ushtron kompetencat që i janë ngarkuar rrethit si person juridik.
6. Përgatit projektbuxhetin e rrethit dhe mbylljen e llogarisë financiare të vitit dhe ia paraqet ato për miratim këshillit të rrethit.
7. Emëron dhe shkarkon personelin e administratës së këshillit të rrethit.
8. Paraqet në këshill raporte vjetore ose edhe më të shpeshta, kur e quan të nevojshme, lidhur me veprimtarinë administrative të këshillit të rrethit, si dhe për gjendjen sociale e ekonomike të tij.

Kryetari i këshillit të rrethit ushtron edhe kompetenca të tjera që i janë ngarkuar me ligj ose nga këshilli i rrethit.

Neni 53

Kryetari i këshillit të rrethit nxjerr urdhra me karakter individual. Këto bëhen të zbatueshme pasi u njoftohen personave të interesuar.

Neni 54

Këshilli i rrethit ka një sekretar të emëruar nga Këshilli iMinistrave mbi bazën e një konkursi. Sekretari është nëpunës shtetëror dhe duhet të ketë mbaruar, si rregull, arsimin e lartë juridik.

Neni 55

Rregullat e parshikuara në këtë ligj lidhur me organizimin e funksionimin e këshillave të komunave dhe bashkive e të kryetarëve të tyre, me përjashtim të kompetencave, zbatohen edhe për këshillin e rrethit dhe kryetarin e tij. Rregullat e parashikuara në këtë ligj për sekretarin e këshillit të komunës ose bashkive zbatohen edhe për sekretarin e këshillit të rrethit.

KREU VII
DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 56

Kryetarët e komunave e të bashkive, kryetarët e këshillave tërretheve, këshilltarët dhe funksionarët e tjerë të administratës lokale i nënshtrohen, sipas rastit, përgjegjësisë materiale, civile, administrative dhe penale, për veprimet e paligjshme të kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 57

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të caktojë kompetencat dhe detyrat e administratës së komunës, të bashkisë dhe të rrethit.

Neni 58

Këshilltarët e komunës, të bashkisë e të rrethit nuk janë funksionarë. Masa e shpërblimit të tyre për kryerjen e detyrave të këshillit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 59

Komitete ekzekutive pluraliste të përkohshme të vazhdojnë veprimtarinë e tyre deri në krijimin e organeve të reja të pushtetit lokal.

Neni 60

Ligji nr.6068, datë 24.12.1979 "Për këshillat popullorë", si dhe çdo dispozitë tjetër lidhur me organizimin, kompetencat e funksionimin e pushtetit lokal, që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 61

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.226, datë 20.6.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha